



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Histori Moderne dhe Bashkëkohore

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare
Viti / Semestri : Viti II, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Spanjolle dhe Qytetërim
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJA DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs synon të njohë proceset historike; lidhjen mes fakteve politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të historisë si dhe rolin që kanë luajtur individë të veçantë; Të analizojë dhe të formojë një gjykim personal, të arsyeshëm dhe aktiv mbi fenomenet e ndryshme historike. Të formojë qytetarë të denjë duke njohur eksperiencën e shtetit modern dhe bashkëkohor, evolucionin e tij dhe procesin e formimit të kombit dhe të burokracisë në Spanjë.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të analizojë dhe të formojë një gjykim personal, të arsyeshëm dhe aktiv mbi fenomenet e ndryshme historike
2. Të formojë qytetarë të denjë duke njohur eksperiencën e shtetit modern dhe bashkëkohor, evolucionin e tij dhe procesin e formimit të kombit dhe të burokracisë në Spanjë

Rezultatet e pritshme:

Në fund të kursit studentët do jenë të aftë të:

1. Të zhvillojë aftësinë e kompetencën e arsyetimit, argumentimit dhe sistemimit të njohurive si nëpërmjet përzgjedhjes së materialeve ashtu edhe nëpërmjet diskutimeve dhe paraqitjes së punimeve dhe projekteve përgjatë kursit.
2. Të ushtrojë një mendim analitik, kritik, logjik dhe kreativ në interpretimin e fenomeneve të ndryshme mbi zhvillimet demokratike në botën perendimore duke i vënë në plan krahasues me ato të Shqipërisë.